

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës

Autoritet za Konkurenciju Republike Kosovo - Competition Authority of the Republic of Kosovo



Nr. 25/23
Datë 24.02.2023

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës mbështetur në nenin 26, nenin 27, nenin 35, nenin 36, nenin 39 si dhe neni 55 paragrafi (2) nën paragrafi (2.4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 05/L-056 (Gazeta zyrtare Nr. 14/22), sipas kërkesës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje kundër Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e mbajtur me datën 24.02.2023 merr këtë:

KONKLUZION

Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, konstatohet se nuk ka argumente për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Komunës së Skenderajt, sipas nenit 36 paragrafi (6), duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës,

A r s y e t i m

Me datën 18.09.2022 AKRK ka pranuar Kërkesën nga Lëvizja Vetëvendosje në email zyrtar *info.konkurrenca@rks-gov.net*, e protokolluar Nr. 312/22-01/H e datës 26.10.2022, përmes së cilës Kërkesë ankuesi Lëvizja Vetëvendosje pretendon se Komuna e Skenderajt ka bërë shkeljen e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës së Skenderajt, lokali me sipërfaqe prej 132m² i është dhënë në shfrytëzim subjektit juridik “Ndona Shpk”.

Pala ankuese kërkon anulimin e kësaj marrëveshje me pretendimin se Komuna ka shkelur Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 2 paragrafi 1, ku thotë se: “*Ky ligj zbatohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet, në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit të Kosovës, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë*”.

Pala ankuese pretendon se është shkel Ligji Nr. 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.

Pala ankuese ka bërë edhe një njoftim të improvizuar dhe një ankand të improvizuar me që rast ka marrë oferta me çmime më të larta se sa oferta e pranuar.

Tregu përkatës apo relevant

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Komunës së Skënderajit.

Tregu i produktit: tregu i produktit konsiderohet Dhënia në shfrytëzim deri në një vit të pronës së paluajtshme, objekteve dhe hapësirave publike në komunën e Skënderajit.

Analiza e Konkurrencës lidhur me rastin


- a) Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me pozitën dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.
- b) Autoriteti i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon në nenin 35 - Propozim për fillimin i Procedurës dhe sipas detyrës zyrtare, neni 36 - Fillimin e procedurës dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e **ndërmarrjeve** që operojnë në tregjet përkatëse. Neni 2 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056 thotë se:
- c) *“Ky ligj zbatohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës nga ndërmarrjet në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit, nëse veprimet e tyre kanë efekt në tregun e Republikës së Kosovës”,* në kuptim të këtij neni, pala ankuese por edhe pala ndaj të cilit ka ardhur ankesa nuk e kanë statusin e ndërmarrjes.
- d) Komuna është person juridik e cila është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore. Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të gjitha niveleve. Komuna e Skënderajit sipas politikës së konkurrencës, në rastin konkret, **nuk konsiderohet ndërmarrje** në kuptim të nenit 2 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, që kryen aktivitet ekonomik dhe si rrjedhojë nuk operon në treg.

- e) Autoriteti konsideron se: në Komunat e Kosovës por edhe në Komunën e Skenderajt, çështja e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për një vit (1) rregullohet me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren Nr. 01-463/01-0051690/20 për Dhënien në Shfrytëzim deri në një vit të pronës së paluajtshme, objekteve, lokaleve dhe hapësirave publike në komunën e Skënderajt.

Ky Konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.


Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës

Komisioni


Neime Binaku-Isufi

Kryetare


Kaltrina Sela
Nënkryetare




Nafije Osdataj
Anëtare

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë konkluzion të njoftohet:

- Pala ankuese
- Publikohet në web faqe të Autoritetit
- Arkiva